



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve

Nr. 2390 prot.

Tiranë, më 30.06.2022

Lënda: Informacion mbi kandidatët e paraqitur për pozicionin e Avokatit të Popullit

Drejtuar: Znj. Klotilda BUSHKA
Kryetare e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut ✓

Për dijeni: Znj. Lindita NIKOLLA
Kryetare e Kuvendit

Këtu

*E nderuar Zonja Kryetare e Komisionit,
Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë,*

Në mbështetje të nenit 61, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 3, 9 dhe 10 të ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111, të Rregullores së Kuvendit, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut me vendimin nr.03/2022 datë 29.03.2022 shpalli vakancën për pozicionin e Avokatit të Popullit.

Me dakordësinë e të gjithë anëtarëve të pranishëm, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, vendosi shtyrjen e afatit për paraqitjen e kandidaturave pranë Kuvendit të Shqipërisë. Afati i fundit për paraqitjen e dokumentacionit të kërkuar ka qenë data 20 qershor 2022.

Në përfundim të afatit janë depozituar kandidaturat si më poshtë:

- | | |
|-----------------------------|----------------------------|
| 1. Ahmet Prenci | 11. Erinda Ballanca |
| 2. Altin Goxhaj | 12. Evis Fico |
| 3. Besim Ndregjoni | 13. Ilirjan Rusmali |
| 4. Bledar Dervishaj | 14. Jordan Daci |
| 5. Borianana Nikolla | 15. Jorida Rustemi |
| 6. Brikena Kasmi | 16. Laureta Roshi |
| 7. Dorian Gjomarkaj | 17. Ledio Braho |
| 8. Drita Avdyli | 18. Lefterije Luzi |
| 9. Endri Papajorgji | 19. Olta Aliaj |
| 10. Ermir Kapedani | 20. Sali Shehu |

Sipas përcaktimeve të pikës 2, të nenit 61 të Kushtetutës, Avokat i Popullit mund të jetë çdo shtetas shqiptar, me arsim të lartë, me njohuri dhe veprimtari të njohura në fushën e të drejtave të njeriut dhe të ligjit. Gjithashtu, sipas nenit 3, të ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, kandidati për të qenë Avokat Populli duhet të plotësojë kriteret si më poshtë:

- a) të jetë shtetas shqiptar*
- b) të ketë njohuri dhe veprimtari të shquara në fushën e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të ligjit*
- c) të shquhet për aftësi profesionale dhe figure të pastër etiko-morale*
- ç) të mos jetë dënuar penalisht*
- d) të mos jetë deputet në legjislaturën e Kuvendit që bën propozimin a zgjedhjen e tij.*

Referuar nenit 10, të ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar,

Avokati i Popullit ndalohet të bëjë pjesë në parti apo organizata politike, të kryejë veprimtari tjetër politike, shtetërore e profesionale dhe të marrë pjesë në organizmat drejtues të organizatave shoqërore, ekonomike dhe tregtare. Ai mund të ushtrojë të drejtën si autor e mësimdhënës.

Sipas njoftimit në faqen zyrtare të Kuvendit, propozimi i çdo kandidature duhet të përmbante:

1. Kërkesë për shprehje interesi për pozicionin e Avokatit të Popullit;
2. CV-në e nënshkruar në çdo faqe nga kandidati dhe fotokopje të kartës së identitetit;
3. Diplomën dhe listën e notave të përfundimit të arsimit të lartë;
4. Librezë pune ose vërtetime të tjera që provojnë përmbushjen e kriterit ligjor të njohurive dhe veprimtarive të shquara në fushën e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të ligjit;
5. Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
6. Formularin e vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

7. Formularin e plotësuar në zbatim të ligjit nr 45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish – Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.
8. Formularin e deklarimit të papajtueshmërisë në përputhje me përcaktimet në nenet 3 dhe 10 të ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar;

Shërbimi i Monitorimit shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga secili kandidat në vlerësim të përmbushjes së kriterëve ligjore, nga ku rezultoi se të gjithë kandidatët:

- ✓ Plotësojnë kriterin ligjor të të qënurit shtetas shqipar.
- ✓ Kanë dorëzuar vërtetimin e gjendjes gjyqësore nga e cila rezultojnë të pa dënuar.
- ✓ Kanë dorëzuar formularët e kërkuar në njoftimin e Kuvendit, me përjashtim të z. Sali Shehu dhe z. Besim Ndrejoni të cilët nuk kanë dorëzuar formularin e deklarimit të papajtueshmërisë në përputhje me përcaktimet në nenet 3 dhe 10 të ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar.

Vlerësimi për çdo kandidatë paraqitet si më poshtë:

1. Z. Ahmet PRENÇI është aktualisht Komisioner i Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, pranë Avokatit të Popullit. Në CV-në e paraqitur dhe të nënshkruar në çdo faqe deklarohet se ka përfunduar studimet në vitin 1991 pranë Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti Bujqësor i Tiranës si dhe në vitin 2002 ka përfunduar studimet për Drejtësi pranë Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranës. Z. Prençi në vitin 2009 ka përfunduar studimet për Master Shkencor në Drejtësi pranë Universitetit Ndërkombëtar të Maqedonisë së Veriut. Sipas librezës së punës, që prej vitit 2002 deri në vitin 2009 ka mbajtur pozicione të ndryshme pune në strukturat e Ministrisë së Brendshme. Në vitet 2009-2013 ka punuar si Inspektor i Lartë në ILDKPI. 2013-2015 ka punuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë si drejtor drejtorie e më pas 2015-2017 si ndihmës inspektor. 2017-2019 ka punuar pranë shoqatës “Liburnetik” si ekspert për menaxhimin e projektit. Z. Prençi është i pajisur me Certifikatë Sigurie lëshuar nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

2. Z. Altin GOXHAI ushtron aktualisht profesionin e avokatit privat pranë firmës “Aga&Goxhaj Law Firm”. Në CV-në e paraqitur dhe të nënshkruar në çdo faqe nga kandidati, deklarohet se ka përfunduar studimet në Fakultetin e Filozofisë dhe Sociologjisë në Universitetin e Tiranës, në vitin 1992. Gjithashtu ka kryer kursin një vjeçar pasuniversitar në Fakultetin e Filozofisë dhe Sociologjisë në Universitetin e Tiranës, në vitin 1993 si dhe është diplomuar në Drejtësi në Universitetin të Tiranës në vitin 1997. Në CV-në deklarohen disa angazhime vullnetare si koordinator, anëtar bordi apo këshilli me veprimtari në fushën e çështjeve sociale, rinisë, mbrotjes së konsumatorit, etj.

3. Z. Besim NDREGJONI momentalisht mban pozicionin e Presidentit të Unionit të Integritit të Burgosurve dhe të Përndjekurve Politik të Shqipërisë. Nëpërmjet fotokopjes së noterizuar të paraqitur nga kandidati provohet se ka përfunduar ciklin e parë të studimeve pranë Universitetit “Kristal” si dhe ciklin e dytë Master në Fakultetin e Drejtësisë pranë këtij universiteti. Nëpërmjet vërtetimit gjyqësor të paraqitur provohet se kandidati nuk rezulton të ketë proces penal sipas të dhënave të rregjistruara. Nëpërmjet dokumentacionit të fotokopjuar kandidati ka deklaruar se ka përfunduar Certifikatën e Sigurimit të Personelit nga DSIK. Nëpërmjet vërtetimeve të paraqitura provohet se kandidati ka punuar pranë Institutit të Integritit të Përndjekurve Politik për një periudhë rreth 5 vjeçare. Nga sa deklarohet në CV, kandidati kryesisht është angazhuar në çështjet të ish të përndjekurve politik.

Nga CV-ja e paraqitur nga kandidati si dhe nëpërmjet dokumentit të fotokopjuar deklarohet se ka përfunduar titullin “Doctor Honoris Causa” për “Marrdhëniet Ndërqeveritare dhe Humanitare” nga Universiteti Amerikan për Paqen Globale SHBA si dhe është dekoruar në vitin 2012 nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë me Urdhrin “Mjeshtër i Madh”, “Për kontribut të rëndësishëm si aktivist i mbrojtjes së të drejtave të njeriut, veçanërisht për integritimin dhe mbështetjen e shtresës së të përndjekurve politik; për veprimtari të çmuar në evidentimin dhe demaskimin e krimeve të regjimit komunist”.

4. Z. Bledar DERVISHAJ aktualisht mban pozicionin e Këshilltarit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut pranë Presidentit të Shqipërisë. Nëpërmjet vërtetimeve të paraqitura provohet se Z. Dervishaj ka përfunduar studimet pranë Universitetit të Tiranës në Fakultetin e Drejtësisë, mban titullin “Avokat” prej vitit 2006.

Ka qenë i angazhuar intensivisht në trajnime dhe aktivitete të shumë fushave, përfshirë edhe ndjekjen me sukses të programit “LEAD Albania” për vitin 2014. Disponon certifikatë të Sigurimit të Personelit, certifikatë të njohjes me informacion të klasifikuar të EU dhe NATO, nga DSIK.

Z. Dervishaj ka eksperiencë profesionale për rreth 21 vite punë. Sipas CV-së ai ka qenë i angazhuar si anëtar i Bordit të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, emëruar nga Këshilli Ministrave, anëtar i Këshillit Drejtues në Shkollën e Magjistraturës, si përfaqësues i Ministrisë të Drejtësisë, anëtar i Këshillit Drejtues të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror, emëruar nga Ministri i Drejtësisë si përfaqësues i Republikës së Shqipërisë në Komitetin e Konventës së Krimit Kibernetik pranë Këshillin e Europës, anëtar i grupit të punës në Ministrinë e Drejtësisë për çështje të luftës kundër terrorizmit, anëtar, ekspert i caktuar si përfaqësues i Ministrisë të Drejtësisë pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar për diskutimin/konsultimin e disa ligjeve pjesë e procesit të reformës në sistemin e Drejtësisë.

Që prej muajit Mars 2018 e në vijim, përfaqësues i autorizuar i Presidentit të Republikës së Shqipërisë pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, përfaqësues Ligjor i Presidentit i Republikës për çështjet për të cilat është kërkuar Opinion nga Komisioni i Venecias nga ku përfshihej apo lidhej Institucioni i Presidentit të Republikës si dhe përfaqësues ligjor dhe person i autorizuar nga Presidenti i Republikës në të gjithë gjykimet kushtetuese të zhvilluara përgjatë

vitit 2021-2022. Lektor i jashtëm (pedagog i ftuar) për ciklin e leksioneve të së Drejtës Civile “E drejta e pronësisë”, gjatë vitit akademik 2019 në Universitetin Jo Publik “Tirana Biznes University” si dhe Lektor i jashtëm (pedagog i ftuar) për lëndën “E drejta publike” gjatë vitit akademik 2020-2021 në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë.

5. Znj. Boriانا NIKOLLA aktualisht mban detyrën e Drejtores së Departamentit Juridik, Kontrollit dhe Zbatimit të Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit dhe Etikës pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit. Në CV-në e paraqitur dhe të nënshkruar në çdo faqe nga Znj. Nikolla, deklarohet se ka përfunduar studimet në Drejtësi në Universitetin “Luarasi”, në vitin 2010. Ka marrë titullin “Avokat” nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe titullin “Avokat i Shtetit”, nga Avokatura e Shtetit. Nga librezja e punës rezultojnë rreth 8 vite pune, në disa institucione si, shoqëria “Sori-AL”, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Avokatura e Shtetit, Kontrolli i Lartë i Shtetit.

6. Znj. Brikena KASMI është diplomuar në vitin 2001, në Fakultetin Juridik, pranë Universitetit të Tiranës. Në vitet 2010-2011 ka kryer Master në Fakultetin Juridik, pranë Universitetit të Tiranës. Në vitin 2016 ka mbrojtur titullin “Doktor i Shkencave” në Fakultetin Juridik, pranë Universitetit të Tiranës. Sa i takon përvojës së punës, duke iu referuar CV-së së znj. Kasmi nga viti 2014 e në vazhdim punon si avokate pranë një studio konsulence, në vitet 2016-2019 ka punuar si lektore në Fakultetin Juridik, pranë Universitetit të Tiranës, nga viti 2012 e në vazhdim ka punuar si lektore pranë një universiteti privat, në vitet 2020-2022 ka punuar në një projekt të Këshillit të Evropës, në vitet 2015 e në vazhdim ka punuar si eksperte pranë fondacionit Konrad Adenauer. Në vitet 2010-2013 ka mbajtur detyrën e Zv/Ministres së Drejtësisë. Në vitet 2011-2014 ka qenë lektore pranë Shkollës së Magjistraturës. Në vitet 2003-2010 ka punuar si juriste në Ministrinë e Drejtësisë.

7. Z. Dorian GJOMARKAJ që nga nëntori i vitit 2021 ushtron detyrën e Ndhmësit pranë Kabinetit të Zëvendëskryetarit të Kuvendit. Në CV-në e paraqitur nga kandidati, deklarohet se ka përfunduar studimet Bachelor në vitin 2009, në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe më pas në vitin 2012 studimet Master në Marrëdhënie Ndërkombëtare, pranë Universitetit “Roma Tre”, në Romë, Itali. Në vitin 2021 ka përfunduar studimet Doktorale për Studime Politike, në Universitetin “Sapienza”. Dokumentet që provojnë diplomimin e kandidatit nuk janë të njehsuara nga shteti shqiptar.

Z. Gjomarkaj ka eksperiencë profesionale si këshilltar i Kabinetit të Kryetarit të Bashkisë Lezhë për periudhën 2016-2019, gjatë kësaj periudhe deklaroi se ka qenë i angazhuar edhe si ekspert i Komisionit të Reformës Zgjedhore. Z. Gjomarkaj gjatë qëndrimit në shtetin italian ka qenë i punësuar pranë disa OJF-ve dhe për periudhën 2010-2013 si specialist i Zyrës Konsullore të Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Itali.

8. Znj. Drita AVDYLI është diplomuar në vitin 1988, në Fakultetin Ekonomik, të Universitetit të Tiranës dhe në vitin 2006 edhe në Fakultetin Juridik, të Universitetit të Tiranës. Gjithashtu, në vitet 2009-2011 ka kryer Masterin shkencor pranë “Universita degli Studi di Palermo”, Itali. Në vitin 2016 ka mbrojtur titullin “Doktor i Shkencave”.

Sa i takon përvojës së punës, duke iu referuar CV-së dhe librezës së punës të znj. Avdyli nga viti 2013 e në vijim ka punuar si Kryetare e Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësimit. Në periudhën 2006-2013 ka punuar si Komisionere Kombëtare për Refugjatët në Ministrinë e Brendshme. Ndërkohë në periudhën 2002-2006 ka punuar si Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Njerëzore pranë Ministrisë së Bujqësisë. Në vitet 1988-2002 ka punuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Hekurudhave Durrës në pozicionet e Përgjegjëses së Sektorit dhe Kryetares së Departamentit Ekonomik. Znj. Avdyli ka punuar si lektore me kohë të pjesshme në disa universitete private. Në vitin 2006 Znj. Avdyli ka mbrojtur titullin “Avokat”.

9. Z. Endri PAPAJORGJI aktualisht mban pozicionin e Këshilltarit të Kabinetit pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë si dhe është Dekan i Fakultetit të Drejtësisë pranë Tirana Business University College. Nëpërmjet vërtetimeve të paraqitura provohet së z. Papajorgji ka përfunduar studimet pranë Karl Franzes Universitat Graz (Austri) në Fakultetin e Drejtësisë. Mban titullin “Profesor i Asociuar”.

Nëpërmjet CV-së së paraqitur kandidati ka deklaruar se nga tetori 2007 e në vazhdim është pedagog i jashtëm (Titullar) pranë Karl Franzes Universitat Graz (Austri), Universitetit të Elbasanit, Shkodrës, Durrësit, Universitetit Europian të Tianës, Epoka etj. Nga Janari 2008-tetori 2014, Konsulent ligjor pranë IIPCCL-Austria. Pozicionet e deklaruara me lartë nuk janë të provuara nëpërmjet vërtetimeve ose librezës së punës. Nga librezja e punës provohet se kandidati ka vjetërsi pune prej rreth 12 vite. Nëpërmjet vërtetimit të paraqitur kandidati provon së është anëtar i Bordit shkencor të Konferencave Ndërkombëtare “Për të drejtat e njeriut”.

10. Z. Ermir KAPEDANI është diplomuar në vitin 1996, në Fakultetin Juridik, të Universitetit të Tiranës. Duke iu referuar CV-së dhe librezës së punës të z. Kapedani rezulton se nga viti 2019 e në vazhdim ka punuar si ekspert pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në një projekt të financuar nga Banka Botërore. Në periudhën 2014-2019 ka punuar Komisioner pranë Avokatit të Popullit, ndërkohë në periudhën 2009-2014 ka punuar si jurist pranë Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë. Në periudhën 1999-2012 ka punuar si Drejtor Projekti në disa projekte të financuara nga Fondacioni Soros, OSBE, Kompania AMC, Komisioni Evropian etj. Në periudhën 1998-1999 ka punuar si koordinator i projektit “Zhillimi i aktiviteteve të SHVSH”.

Z. Kapedani gjatë karrierës së tij ka qenë anëtar i Këshillit Kombëtar Drejtues të Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë, Kryetar i Forumit Rinor të të Verbërve të Shqipërisë, etj.

11. Znj. Erinda BALLANCA është diplomuar në vitin 1996, në Fakultetin Juridik, të Universitetit të Tiranës. Në vitin 2017 znj. Ballanca u zgjodh nga Kuvendi i Shqipërisë si Avokate e Popullit për një mandat 5 vjeçar. Në vitin 2008-2017 ka punuar si ortake dhe drejtuese në firmën e saj ligjore “Ballanca Law Firm”.

Në periudhën 1996-2008, ajo ka punuar pranë një studio ligjore private. Paralelisht me detyrat e mësipërme znj. Ballanca ka qenë edhe anëtare e Grupit Koordinues përgjegjës për organizimin dhe shpërndarjen e informacionit gjatë procesit kushtetues në vitin 1998, pedagoge e jashtme në Fakultetin Juridik pranë Universitetit të Tiranës në lëndët e Drejtë Kushtetuese, Teknikë Legjislative, etj.

Znj. Ballanca në vitin 1997 ka fituar titullin “Avokat”, është anëtare e Dhomës së Avokatëve Tiranë që nga viti 1997, dhe ka mbajtur pozicione drejtuese si në Bordin Drejtues të Dhomës së Tiranës, ashtu edhe në Asambleenë Kombëtare të Dhomës së Avokatëve.

12. Znj. Evis FICO momentalisht mban pozicionin e Këshilltares së Ministres së Financave dhe Ekonomisë. Në CV-në e paraqitur nga znj. Fico deklarohet se ka përfunduar studimet në Fakultetin e Drejtësisë, të Universitetit Kombëtar e Kapodistrian të Athinës në vitin 2004 dhe më pas studimet pasuniversitare Master në Studime të Evropës Juglindore, në vitin 2005, në të njëjtin universitet. Gjatë viteve të ushtrimit të profesionit është angazhuar vazhdimisht në kualifikimin profesional dhe akademik duke përfituar një sërë certifikatash, si Certifikatë në Programin Vjetor për Drejtësi dhe Ekonomiks, në Riga School of Laë të Letonisë, Certifikatë për programin vjetor Shkolla Shqiptarë e Studimeve Politike, të mbështetur nga Këshilli i Evropës.

Znj. Fico ka një eksperiencë profesionale në vend prej 16 vitesh punë, fillimisht si përgjegjëse sektori pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit për një periudhë 12 vjeçare, lektore e lëndës së të “Drejtës Migratore”, në Fakultetin e Drejtësisë së Universitetit të Tiranës, këshilltare ligjore e Komitetit Shtetëror të Minoriteteve për një periudhë afërsisht 2 vjeçare, Këshilltare dhe më pas Drejtoresh Kabineti e Ministrit të Drejtësisë për një periudhë 2 vjeçare.

13. Z. Ilirjan RUSMALI që nga tetori i vitit 2020, ushtron detyrën e anëtarit të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Në CV-në e paraqitur nga kandidati, deklarohet se ka përfunduar studimet në vitin 1987, në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, më pas në vitin 1994 ka përfunduar studimet pasuniversitare në specialitetet E Drejta Kushtetuese, të Drejtat e Njeriut dhe e Drejta Ndërkombëtare Publike, pranë Institutit “Max Planck”, të Universitetit Heidelbergut, Gjermani. Kandidati nuk ka paraqitur dokumentacionin që provon kualifikimet e deklaruara në CV.

Z. Rusmali ka një përvojë të gjatë profesionale dhe politike. Ai ka qenë lektor i të Drejtës Kushtetuese në Fakultetin e Drejtësisë, të Universitetit të Tiranës për një periudhë afërsisht 4 vjeçare, më pas është aktivizuar në periudhën 1995-1997 në administratën e lartë shtetërore, si këshilltar juridik në institucione si Kryeministria, Presidenca dhe Kuvendi, në periudhën 1998-2001 ka ushtruar profesionin e juristit në sektorin privat dhe bashkëthemeluesit dhe drejtorit të

disa OJF-ve të rëndësishme në fushat e edukimit ligjor, mbrojtës së të drejtave të njeriut, etj. Nga shtatori i vitit 2013 ka qenë ekspert ligjor i pavarur dhe bashkëpunëtor në projekte të ndryshme të OSCE-së, UN Women, NDI. Gjithashtu për periudhën 2017-2020 z.Rusmali ka ushtruar detyrën e Këshilltarit të Kryetarit të KQZ-së.

Z. Rusmali ka një përvojë të konsiderueshme politike përgjatë viteve 2001-2013, ai ka qenë i zgjedhur për dy mandate anëtar i Këshillit Bashkiak Tiranë (2000, 2003) dhe për dy mandate të tjera deputet i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (2005, 2009) dhe në vitet 2005-2008 ka ushtruar detyrën e Zëvendëskryeministrit dhe Ministrit të Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë. Përgjatë veprimtarisë parlamentare ka mbajtur detyrën e Kryetarit të Komisionit të Çështjeve Ligjore, të Drejtave të Njeriut dhe Administratës Publike, ka qenë anëtar i Këshillit të Legjislacionit dhe i Komisionit të Mandateve dhe Imuniteteve, si dhe bashkëdrejtues i Komisionit *ad-hoc* të reformës zgjedhore të kohës. Gjithashtu, ai ka qenë kryetar i delegacionit parlamentar të Shqipërisë në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës.

14. Z. Jordan DACI aktualisht mban pozicionin e Dekanit të Fakultetit të Drejtësisë në Kolegjin Universitar Qirjazi njëkohësisht është edhe pedagog i disa lëndëve pranë këtij Kolegji dhe Shkollës së Lartë Universitare “Tirana Business University”.

Në vitin 2002 është diplomuar si jurist pranë Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, me rezultate të larta. Në vitin 2002-2003 ka kryer studimet pasuniversitare për gradën Master për Demokraci dhe të Drejtat e Njeriut në Europën Juglindore, në Universitetin e Bolonjës. Në maj 2010 ka përfunduar studimet për gradën “Doktor i Shkencave” në të “Drejtë Publike” pranë Fakultetit të Drejtësisë në Universitetin e Tiranës. Zotëron titullin akademik “Profesor i Asociuar” në Drejtësi. Në vitin 2004 ka fituar titullin “Avokat”.

Z. Daci ka deklaruar në CV-në e tij se ka 19 vite përvojë punë akademike. Gjithashtu, ka edhe disa ekperiencia si, Këshilltar Ndërkombëtar Ligjor pranë Ministrisë së Financave Kosovë (2006-2008), Këshilltar pranë Ministrisë së Financave në Shqipëri (2014-2015), Këshilltar i Kryetarit të Gjykatës së Lartë. Që prej vitit 2017 e në vijim, z. Daci është drejtues dhe ortak i vetëm i studios ligjore “Daci and Associate”, gjithashtu është autor i tekstit universitar për lëndën e të Drejtave të Njeriut, si tekst bazë në arsimimin ligjor në vend, autor i 36 botimeve në revista shkencore jashtë dhe brenda vendit etj.

15. Znj. Jorida RUSTEMI që prej vitit 2018 e në vijim mban detyrën e Këshilltares së Avokatit të Popullit. Në vitet 2014-2018 ka qenë Drejtuese e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës pranë Avokatit të Popullit. Në CV-në e paraqitur deklarohet se në vitin 2000 ka përfunduar studimet në Psikologji Klinike pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale me vlerësimin “Student i shkëlqyer”. Gjithashtu në vitin 2001-2003 ka kryer studimet Master me drejtim “Këshillim Psikologjik” pranë Universiteti të Tiranës, Fakulteti i Shkenave Sociale, si dhe “Master Shkencor” në Psikologji Klinike pranë Universitetit të Emporias në Kansas, SHBA, gjatë viteve 2007-2009. Në vitin 2019 ka fituar gradën shkencore “Doktor” në “Psikologji” pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës.

Nga librezat e punës rezultojnë eksperiencat e punës si drejtoreshë ekzekutive pranë Institutit Shqiptar për Studime Sociale dhe Psikologjike, (2000-2003). Më pas 2004-2006 ka qenë as/pedagoge me kohë të plotë pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, pranë Universitetit të Tiranës dhe më pas 2006-2007 ka punuar si pedagoge pranë këtij fakulteti. Në CV deklarohen disa eksperiencat e punës si eksperte psikologje pranë Institutit Europian të Tiranës, eksperte e pavarur pranë Koalicionit Shqiptar Kundër Korrupsionit, eksperte pranë Institutit për Zhvillim, Kërkim dhe Alternativa, eksperte Kombëtare për OSBE në Shqipëri.

16. Znj. Laureta ROSHI që nga tetori i vitit 2021 mban pozicionin e specialistes së marketingut pranë Albpetrol sh.a. Në CV-në e paraqitur nga kandidatja, deklarohet se ka përfunduar studimet në Fakultetin e Shkencave të Edukimit, Dega Cikli Fillor, të Universitetit të Elbasanit, në vitin 1991 dhe më pas në vitin 2013 studimet pasuniversitare në Histori, në Fakultetin e Histori - Filologjisë, në Universitetin e Tiranës.

Znj. Roshi ka një vjetërsi pune në vend prej pothuajse 30 vitesh, fillimisht si mësuese e ciklit fillor, e më pas si gazetare, korrespondente e disa televizioneve, kryeredaktore e redaktore e disa revistave dhe këshilltare e Kabinetit të Kryetari të Bashkisë Fier. Nga viti 2016 e deri në fund të vitit 2019 kandidatja ka qenë e punësuar pranë institucionit të Avokatit të Popullit si nëpunëse e marrëdhënieve me publikun.

17. Z. Ledio BRAHO që nga tetori i vitit 2020 ushtron detyrën e anëtarit të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Në CV-në e paraqitur nga z. Braho, deklarohet se ka përfunduar studimet në vitin 2009, në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës. Më pas në vitin 2011 ka përfunduar studimet pasuniversitare Master në të Drejtë Ndërkombëtare të Njeriut dhe Ligj Humanitar, në Europa Iniversitat Viadrina, Frankfurt Oder, Gjermani. Kandidati ka fituar titullin e Avokatit në vitin 2011 dhe që nga viti 2017 është anëtar i Këshillit të Përgjithshëm të Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë, si dhe nga 2019 anëtar i Komitetit Disiplinor të DASH-së. Në vitin 2012 ka fituar titullin “Ndërmjetës”. Në vitin 2015 z. Braho ka qenë konsulent i Rrjetit të Profesionistëve të Konsultimit Publik, të Grupit për Reformën në Sistemin Gjyqësor.

Z. Braho ka eksperiencë profesionale prej 11 vitesh, ai ka qenë lektor i të Drejtës Ndërkombëtare Publike dhe Private për periudhën 2011-2016 Fakulteti i Shkencave Shoqërore, të “Albanian University”, specialist pranë Ministrisë së Integritimit, inspektor i Inspektoratit Qendror, këshilltar ligjor i institucionit të Presidentit të Republikës. Që nga 2015 e në vijim është anëtar dhe administrator i “B&K Legal & Tax Consulting” sh.p.k. Kandidati ka qenë i angazhuar intensivisht në trajnime dhe aktivitete të shumë fushave, përfshirë edhe ndjekjen me sukses të programit “LEAD Albania” për vitin 2014.

18. Znj. Lefterije LUZI aktualisht mban pozicionin e Drejtoreshës së Shërbimit të Komisioneve pranë Kuvendit të Shqipërisë. Znj. Luzi ka përfunduar studimet në Fakultetin e Drejtësisë, të Universitetit të Tiranës në vitin 1992 dhe më pas studimet pasuniversitare Master në “Marketing të Avancuar”, në Fakultetin e Ekonomisë, të Universitetit të Tiranës. Znj. Luzi ka fituar titullin “Avokat” në vitin 2005 dhe titullin “Ndërmjetëse” në vitin 2012. Në prill të vitit 2022 ka marrë gradën Doktor Shkencash në drejtësi. Znj. Luzi nuk ka paraqitur dokumentacionin përkatës që provon se ka përfunduar studimet në Doktoraturë si dhe listën e notave të përfundimit të studimeve të shkollës së lartë.

Znj. Luzi ka një eksperiencë pune që nga viti 1992, në pozicione drejtuese si të administratës publike por dhe të institucioneve të pavarura siç është pozicioni i anëtares së KLD-së dhe pozicioni i Kryetares së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për një mandat 4 vjeçar, etj. Gjatë viteve të ushtrimit të profesionit ka qenë e angazhuar intensivisht në trajnime dhe aktivitete të shumë fushave. Znj. Luzi është bashkëautore dhe autore e disa botimeve, me fokus të veçantë sistemet dhe proceset zgjedhore.

19. Znj. Olta ALIAJ aktualisht është Komisionere e Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve pranë Avokatit të Popullit. Znj. Aliaj ka mbaruar arsimin e lartë në vitin 2001, në Universitetin e Bolonjës, Itali, me diplomë në degën “Drejtësi”. Në vitin 2005 është diplomuar në master të nivelit të dytë në “Studime Ligjore Ndërkombëtare”, në Kolegjin Juridik të Washingtonit.

Referuar librezës së punës ka të paktën 10 vite pune në profesion si juriste. 2011-2019 ka punuar si Këshilltare e Gjyqtarëve pranë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në vitin 2009-2010 ka punuar si avokate pranë studios ligjore “Loloci&Associates”, ndërsa referuar CV në vitet 2005-2009 ka punuar si avokate pranë studios ligjore “Sidley Austin LLP” Washington.

20. Z. Sali SHEHU aktualisht mban pozicionin e këshilltarit ligjor të kompanisë “Gjoka Konstruksion” dhe Eurovin. Në CV-në e paraqitur nga kandidati, deklarohet se ka përfunduar studimet në vitin 1989 në Shkollën e Lartë të Ministrisë së Brendshme, më pas në vitin 1998 ka përfunduar studimet në Fakultetin Juridik të Universitetit “Luigj Gurakuqi”. Në vitin 2005 ka përfunduar studimet pasuniversitare Master në Drejtim Penal, në Fakultetin e Drejtësisë së Fakultetit të Tiranës dhe në vitin 2018 ka marrë gradën shkencore “Doktor” pranë këtij Universiteti.

Z. Shehu ka një eksperiencë profesionale të gjatë në fusha të ndryshme, për periudhën 1989-1997 ka ushtruar funksione të ndryshme në Policinë e Shtetit, nga viti 2001 deri më 2009 ka ushtruar detyrën e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë në dy Legjislatura, nga viti 2010 deri më 2012 ka qenë i punësuar pranë KLD-së, ndërsa nga 2014-2017 ka ushtruar detyrën e këshilltarit të kabinetit të Kryetarit të Kuvendit. Kandidati ka deklaruar në CV-në e tij që gjatë kohës së ushtrimit të detyrës së deputetit ka qenë i punësuar si konsulent ligjor i jashtëm i kompanive private. Kandidati nuk ka paraqitur dokumentacionin që provon eksperiencën profesionale.

Vijimi i procedurës për përzgjedhjen e kandidaturave:

- Sipas përcaktimeve të pikës 4, të nenit 9, të ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, lista e kandidatëve i përcillet komisionit të Kuvendit që mbulon çështjet ligjore për të verifikuar përmbushjen e kritereve kushtetuese e ligjore dhe meritën e çdo kandidature.
- Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut organizon seanca dëgjimore publike me secilin kandidat dhe në përfundim të procesit dëgjimor miraton listën e plotë të kandidatëve të paraqitur, së bashku me vlerësimin për përmbushjen e kritereve kushtetuese e ligjore dhe meritën e çdo kandidature.
- Në vijim, sipas përcaktimit të pikës 5, të nenit 9, të ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, kandidaturat për Avokat të Popullit i paraqiten Kuvendit me shkrim nga jo më pak se 28 deputetë, të përzgjedhur në radhët e kandidatëve që përmbushin kriteret kushtetuese e ligjore dhe meritën, sipas vlerësimit të Komisionit.

Në përfundim të procedurës përzgjedhëse, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 9, të ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, Avokati i Popullit zgjidhet nga tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Në vëmendjen Tuaj,

SEKRETARI I PËRCJITHSHËM

Genci GJONÇAJ

Miratoi: Alkida LLAKAJ
Drejtores, Shërbimi i Monitorimit

Hartoi: Arlinda DINI
Besi LONDO
Marlind MYFTIU
Nivini LEKAJ
Këshilltarë, Shërbimi i Monitorimit